



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VIII

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion, Mandate,
Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen
e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 113

Prishtinë, më 6.6.2024, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

P R O C E S V E R B A L

Në mbledhje morën pjesë: Adnan Rustemi, Artan Abrashi, Dimal Basha, Arijeta Rexhepi, Erxhan Galushi dhe Hydajet Hyseni- Kaloshi.

Munguan: Blerta Deliu-Kodra, Hajdar Beqa, Besnik Tahiri dhe Driton Selmanaj.

Mbledhjen e kryesoi Adnan Rustemi, kryetar i Komisionit.

Te ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: Ema Krasniqi, KDI; Flutura Kusari, aktiviste; Saranda Ramaj, gazetare; Rinor Krasniqi, VV; Erlinda Krasniqi, gazetare; Gëzim Mujaj, gazetar; Lumnije Murati, Presidenca.

Stafi mbështetës i Komisionit: Mirlinda Kolgeci dhe Fatbardha Boletini.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura me datë: 25.4, 30.4, 7.5, 16.5, dhe 23.5.2024;
3. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL për Projektligjin nr.08/L 287 për Këshillin e Sigurisë së Kosovës;
4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL për Projektligjin nr.08/ L-294 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.08/L-197 për zyrtarët publikë;
5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL për Projektligjin nr. 08/L-289 për Komisionin e Pavarur për Media;

6. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL për Projektligjin nr.08/L-275 për rrugët;
7. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Kryetari, konstatoi se me gjashtë vota për, u miratua rendi i ditës

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura me datë: 25.4, 30.4, 7.5, 16.5, dhe 23.5.2024;

Kryetari, konstatoi se u miratuan procesverbalet nga mbledhjet e mbajtura me datë: 25.4, 30.4, 7.5, 16.5, dhe 23.5.2024, pa ndryshime.

3. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL për Projektligjin nr.08/L-287 për Këshillin e Sigurisë së Kosovës;

Kryetari, paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente për Projektligjin nr.08/L-287 për Këshillin e Sigurisë së Kosovës. Ai theksoi se Komisioni për Çështjet e Sigurisë dhe Mbrojtjes, ka paraqitur 7 amendamente. Komisioni për Legjislacion, në pajtim me nenin 76, paragrafi 8 të Rregullores së Kuvendit, vlerëson nëse projektligji dhe raporti me amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin e zbatueshëm.

Meqë nuk pati diskutime të tjera, kryetari konstatoi se me gjashtë vota për, u miratua Raporti me amendamente dhe vendosi që Kuvendit dhe Komisionit FunkSIONAL t'ia paraqes këtë:

Rekomandim

1. Projektligji nr.08/L-287 për Këshillin e Sigurisë së Kosovës dhe amendamentet e propozuara, janë në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL për Projektligjin nr.08/ L-294 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.08/L-197 për zyrtarët publikë;

Kryetari, paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente për Projektligjin nr.08/L-294 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.08/L-197 për zyrtarët publikë. Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal, ka paraqitur 2 amendamente. Komisioni për Legjislacion në pajtim me nenin 76, paragrafi 8 të Rregullores së Kuvendit, vlerëson nëse projektligji dhe raporti me amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin e zbatueshëm. Ky projektligj është rrjedhojë e aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese dhe natyrisht detyrimi për t'i adresuar çështjet të cilat ka evidentuar dhe i ka ngritur Gjykata Kushtetuese.

Meqë nuk pati diskutime të tjera, kryetari konstatoi se me gjashtë vota për, miratohet Raporti me amendamente dhe vendosi që Kuvendit dhe Komisionit FunkSIONAL t'ia paraqes këtë:

Rekomandim

1. Projektligji nr.08/ L-294 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.08/L-197 për zyrtarët publikë dhe amendamentet e propozuara, janë ne pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL për Projektligjin nr. 08/L-289 për Komisionin e Pavarur për Media;

Kryetari, paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente për Projektligjin nr. 08/L-289 për Komisionin e Pavarur për Media dhe theksoi se Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal, ka paraqitur 93 amendamente. Komisioni për Legjislacion në pajtim me nenin 76, paragrafi 8 të Rregullores së Kuvendit, vlerëson nëse projektligji dhe raporti me amendamentet e propozuara janë ne pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.

Meqë nuk pati diskutime të tjera, Kryetari konstatoi se me gjashtë vota për, miratohet Raporti me amendamente dhe vendosi që Kuvendit dhe Komisionit FunkSIONAL t'ia paraqes këtë:

Rekomandim

1. Projektligji nr. 08/L-289 për Komisionin e Pavarur për Media dhe amendamentet e propozuara, janë ne pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

6. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL për Projektligjin nr.08/L-275 për rrugët;

Kryetari, paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente për Projektligjin nr.08/L-275 për rrugët dhe potencoi se Komisioni për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim, ka paraqitur 95 amendamente. Komisioni për Legjislacion, në pajtim me nenin 76, paragrafi 8, të Rregullores së Kuvendit, vlerëson nëse projektligji dhe raporti me amendamentet e propozuara janë ne pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin e zbatueshëm.

Meqë nuk pati diskutime të tjera, kryetari konstatoi se me gjashtë vota për, miratohet Raporti me amendamente dhe vendosi që Kuvendit dhe Komisionit FunkSIONAL t'ia paraqes këtë:

Rekomandim

1. Projektligjin nr.08/L-275 për rrugët dhe amendamentet e propozuara, janë në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

7. Të ndryshme.

Për këtë pikë nuk pati diskutime

Mbledhja përfundoi në orën 13:20

E përgatiti:
Stafi mbështetës i Komisionit.

Adnan Rrustemi,
Kryetar i Komisionit
